



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI I REJOK PËR DREJTAT E NERJOKUT



Raport monitorues 16-të

*mbi punën e ekzekutivit të komunës së
Lipjanit*

Nëntor 2017

Përmbajtja:

Hyrje,	Faqe 2
Përmbledhje ekzekutive,	Faqe 3
Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti,	Faqe 4
Problemet aktuale,	Faqe 11
Transparenca dhe llogaridhënia	Faqe 11
Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit	Faqe 11
Drejtoria e prokurimit	Faqe 13
Arsimi	Faqe 16
Shëndetësia	Faqe 17
Tatimi në pronë	Faqe 18
Burimet:	Faqe 18

Lista e tabelave:

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.	Faqe 5
Tabela 2. Vlerësimi i realizimit të premtimeve sipas vendbanimeve	Faqe 10
Tabela 3. Buxheti komunal i planifikuar 2017	Faqe 12
Tabela 4. Buxheti komunal 2003/2016	Faqe 12
Tabela 5. LISTA E TËNDERVE TË KONTRAKTUARA NGA DREJTORIA KOMUNALE E PROKURIMIT NË LIPJAN GJATË PERIUDHËS JANAR-QERSHOR 2017	Faqe 14
Tabela 6. Numri i nxënësve dhe i personelit arsimor në Komunën e Lipjanit	Faqe 16
Tabela 7. Struktura e punëtorëve në QKMF në muajin Maj të vitit 2017	Faqe 17

Lista e grafikoneve:

Grafiku 1. Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit IMRI AHMETI për realizimin e premtimeve	Faqe 8
Grafiku 2. Vlerësimi i realizimit të premtimeve sipas vendbanimeve	Faqe 8
Grafiku 3. Dinamika e realizimit të premtimeve nëpër vite 2014-2016	Faqe 10
Grafiku 4. Të hyrat komunal nga lloji i burimit	Faqe 12
Grafiku 5. Aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Prokurimit	Faqe 13

Adresa: Rr."Tahir Sinani" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"



OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) që nga viti 2009 ka filluar me një mision shumë të vështirë dhe sfidues si organizatë e shoqërisë civile në monitorimin e institucioneve lokale në Komunën e Lipjanit. Gjatë kësaj periudhe tetë vjeçare është përballur me shumë vështirësi dhe probleme të natyrës së jashtëm si që janë: Kërcënimet, shantazhet, linçime etj. Por, falë punës sonë dhe të përkrahjes së organizatave ndërkombëtare ja kemi arritur në përmbushjen e objektivave tona. Ku një falënderim të veçantë i shkon Ambasadës Amerikane në Prishtinë, OLOF Palme nga Suedia dhe organizatave tjera .



Organizata e falënderon qytetarët e Komunës së Lipjanit inkurajimin dhe besimin e dhënë organizatës sonë në vazhdimin e punës në monitorimin e institucioneve lokale të Komunës së Lipjanit. YAHR do të vazhdojë gjatë këtij viti në listimin e të gjitha premtimeve të kandidatëve për kryetar komune nga partitë politike në zgjedhjet lokale 2017 dhe më pas do të monitorojë përmbushjen e premtimeve të kryetarit të zgjedhur për mandatin qeverisës 2017/2021.

*Bekim Krasniqi
Drejtorekzekutiv i YAHR-it*

Hyrje

Youth Association for Human Rights (YAHR) për gjatë pjesës së parë të vitit 2017 nëpërmjet monitoruesve të saj nga afër ka përcjellë punën e ekzekutivit si dhe funksionimin e legjislativit të komunës së Lipjanit. Ky monitorim ka pasur për qëllim të identifikojë jo vetëm të metat eventuale të qeverisjes si dhe shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi por edhe të shënojë ngritjen e institucioneve si në aspektin e rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit të buxhetit dhe aplikimit të frymës demokratike të marrjes së vendimeve si dhe të komunikimit dhe të transparencës.

Vendimmarrja e cila prekë interesat e qytetarëve duhet të merret sa më afër tyre, këtë e siguron parimi i subsidiaritetit. Kjo u mundëson qytetarëve që të përfitojnë shërbime publike më të mira dhe në mënyrë më efikase dhe transparente nga organet komunale. Gjatë procesit të monitorimit YAHR-i ka synuar të rrisë besueshmërinë e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes por edhe të sigurojë një prani të përherëshme të një mbikëqyrje transparente të funksionimit të pushteteve me theks të veçantë të transparencës në raport me qytetarin. Duke u nisur nga bindja se procesi i monitorimit është i domosdoshëm për këtë shkallë të zhvillimit të demokracisë sonë, derisa ende institucionet tona përballen me ngërçe institucionale dhe me mos- transparencë, YAHR-i konsideron se me punën e monitorimit është mundësuar një dobi e dyfishtë edhe në raport me institucionet por edhe me qytetarin. Institucionet komunale kanë pasur mundësi të dëgjojnë një zë jo kundërshtues apo refuzues arbitrar, por një zë të këshillës dhe të sugjerimit për të avancuar proceset. Ndërkaq qytetari ka fituar një zë të sigurt, një vlerësim bindës për zhvillimet brenda institucioneve komunale duke mësuar kështu më mirë se kah dhe ku harxhohet paraja publike, apo si janë caktuar prioritetet e projekteve.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t’iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar - Qershor 2017. Monitorimi është fokusuar në Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: e premtimeve të kryetarit të komunës, transparencës dhe llogaridhënies, demokratizimit dhe qeverisjes së mirë, zhvillimit urban e ekonomik, arsimit dhe shëndetësisë. YAHR-i gjatë përpilimit të këtij raporti është bazuar në bazë të informatave të mbledhura në teren nga qytetarët, nga raportet mujore dhe vjetor i kryetarit për vitin 2017, nga monitorimi i drejtpërdrejtë të aktiviteteve të punës së ekzekutivit, nga mediat dhe nga shumë informacione të ndryshme.

Ekzekutivi i Komunës së Lipjanit edhe gjatë kësaj periudhe Janar – Qershor 2017 është përballur me shumë vështirësi. Për shkak të mos funksionimit të Kuvendit Komunal nga bojkoti i partive opozitare. Ku kemi shtyrjen e aprovimit dhe të rritjes së buxhetit komunal për Vitin 2016 dhe të bartjes së të hyrave nga vitet paraprake, në vlerë prej 757,608.27€ në vitin buxhetor 2017. Vonesa e bartjes së të hyrat ka shkaktuar ndikim drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe performancën financiare. Kjo ka ndikuar në uljen e përqindjes së shpenzimeve të buxhetit dhe të krijimit të obligimeve financiare për një kohë të caktuar. Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën 1 Janar-31 Maj 2017 ka arrit që të shpenzohet në masën 30.82 % nga buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2017, që është 14,025,258.00 €, ndërsa pjesa më e madhe e shpenzimeve pritet të realizohet në tre mujorin e fundit të 2017.

Në këtë raport monitorues është paraqitur edhe performanca e kryetarit të Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti , në përmbushjen e premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore për kryetar komune në vitin 2013, i cili kishte premtuar 130 projekte konkrete për 62 vendbanime të Komunës së Lipjanit. Organizata YAHR për të qenë sa më objektiv në vlerësimin e premtimeve, ka organizuar një vargë takimesh me qytetarë , subjekte politike, përfaqësues të fshatrave, shoqërinë civile , mediat dhe zyrtar komunal. Pas analizimit të burimeve të lartpërmendura kemi ardhur deri tek këto të dhëna: Ku nga 130 premtime të premtuar kemi vetëm 46 premtime ose 35.38 % të realizuar plotësisht, ndërsa 32 premtime / projekte ose 24.61 % ka lëvizje ose ka ngecje në realizimin e tyre dhe 52 premtime ose 40 % nuk kemi asnjë lëvizje konkrete në realizimin e tyre.

Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e ekzekutivit ndaj qytetareve, ende po vazhdohet me një nivel të ultë në këto dy shtylla të qeverisjes së mirë. Pasi që, kryetari Imri Ahmeti vazhdon të mbaj të mbyllura dyert, me anë të selektimit të organizatave të shoqërisë civile, në ato të përshtatshme dhe ato të jo të përshtatshme për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit të drejtorëve. Po ashtu po vazhdohet me bojkot me mos dërgimit të materialeve të kuvendit ndaj organizatave të interesuar që ta përcjellin mbledhjet e Kuvendit.

Ndërsa, si shenja pozitive për këtë periudhe kemi vazhdimin e performancës së mirë në arkëtimin e të hyrave vetanake nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Ku deri me 31 Maj 2017 janë realizuar në vlerë 659,877.43 € ose 31.29 % nga planifikimi vjetor , që është 2,108,545.00 euro për vitin 2017. Ndërsa realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë është realizuar në vlerën 203,029.93 € ose 26.89 % nga planifikimi që është 755,000.00 €.

Profili i Kryetarit Imri Ahmeti



Imri Ahmeti u lind më 05.08.1964, në fshatin Torlnë, komuna e Lipjanit, shkollën fillore e kreu në fshatin Rufc, ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Është i diplomuar në fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës.

Profesor i Lëndëve Juridike në gjimnazin në Lipjan 1994-1999, Shef i Inspektoratit 1999-2000, Shefi i sektorit për regjistrimin e bizneseve 2004-2007, Kryeshef Ekzekutiv 2004-2007, Këshilltar politik në Kabinetin e Presidentit të Kosovës 2007-2008, Këshilltar i lart politik i Zëvendës së kryeministrit të Qeveris së Kosovës z. Ramë Manaj 2008-2010, zv/ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Qeverinë e Republikës së Kosovës 2010, Deputet në Parlamentin e Kosovës 2011-2013, Nga viti 2013 kryetar i Komunës së Lipjanit¹.

Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti

Organizata Joqeveritare **Youth Association For Human Rights – YAHR** kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Imri Ahmeti, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2013 dhe 7 – 12 dhjetor 2013². Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne dhe gjithashtu nga dy debatet të mbajtura në “Jeta në Kosovë”³, në mes të tjerash Kryetari Ahmet ka premtuar:

Projektet konkrete të premtuar nga kryetari Imri Ahmeti në zgjedhjet lokale për kryetar të Lipjanit 2017, për mandatin katër vjeçar 2017-2020
255*

Lipjani:(29)

1. Vazhdimi i ndërtimit të rrugëve, trotuareve dhe ndriçimit publik në të gjitha lagjet e qytetit (trajtim i veçantë: Lagja e Akllapit dhe Konjuhiti);
2. Hapja e rrugëve – unazë jashtë qytetit që do ta lidhë pjesën lindore me pjesën perëndimore nëpërmes rrugëve tranzite;
3. Asfaltimi i rrugës “Sadik Shala” deri në magjistralen Prishtinë-Ferizaj;
4. Përfundimi i rrugës me katër korsi nga rreth rrotullimi tek ETC deri në qytet;
5. Asfaltimi i rrugës me katër korsi me infrastrukturë përcjellëse (shtigje të biçikletave, shtigje për këmbësorë) nga Lipjani - deri te rrethrotullimi te Banulla;
6. Ndërtimi i rrethrotullimit në hyrje të Lipjanit afër Qendrës së zjarrfikësve,

¹ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/Biografia-e-Kryetarit.pdf.aspx>

² <http://zgjedhjet2013.weebly.com/programet-e-partive-politike-peumlr-zgjedhjet-2013.html>

³ <http://zgjedhjet2013.weebly.com/tv-debatet.html>

7. Ndërtimi i rrugës përgjatë brezit të hekurudhës ndërmjet magjistrales Prishtinë – Prizren deri te rruga e Gllogovcit;
8. Ndërtimi i shkollës fillore në qytet;
9. Ndërtimi i një Qendre Rinore në qytetin e Lipjanit;
10. Ndërtimi i sallës së sporteve te shkolla "Ismail Luma" në Lipjan;
11. Ndërtimi i kompleksit sportiv te shkollat e mesme në Lipjan;
12. Ndërtimi i një fushe të hapur sportive në shkollën "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan;
13. Ndërtimi i objektit për aktivitetet e personave me nevoja të veçanta;
14. Ndërtimi i pjerrinave adekuate për persona me nevoja te veçanta në objektet publike dhe në rrugët e qytetit;
15. Renovimi i objektit të QKMF-së dhe objekteve përcjellëse;
16. Rregullimi i parkingjeve dhe menaxhimi i tyre;
17. Rregullimi i parkingjeve nëntokësore mbrapa komunës dhe rregullimi i hapësirave gjelbëruese.
18. Ndërtimi dhe gjelbërimi i hapësirave të reja publike dhe mirëmbajtja e tyre;
19. Ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë;
20. Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit "Sitnica";
21. Fasadimi i ndërtesave kolektive në shesh dhe në ndërtesat tjera kolektive të qytetit;
22. Ndërtimi i objekteve për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së dhe për familjet pa strehë banimi;
23. Ndërtimi i Objektit të ri të Administratës së Komunës;
24. Dislokimi dhe ndërtimi i tregut të gjelbërt dhe tregut të kafshëve;
25. Instalimi i kamerave të sigurisë në rrugët e qytetit dhe instalimi i fibrave optike;
26. Ndërtimi i objekteve të reja me interes publik në partneritet publikoprivat në pronat komunale si:
27. Ndërtimi i qendrës zejtare, ndërtimi i çerdhes për fëmijë,
28. Projektimi dhe ndërtimi i ngrohjes qendrore etj.
29. Projekt i veçantë është ndërtimi i tubacioneve për derdhjen e ujërave të zeza nga rrjetet e kanalizimeve të disa vendbanimeve të komunës së Lipjanit në impiantin regjional i cili do të ndërtohet me financim të Bashkimit Evropian.

Konjuh:(5)

1. Asfaltimi i rrugicave;
2. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik deri në Lipjan;
3. Ndërtimi i shtratit të lumit;
4. Hapja dhe ndërtimi i rrugës Konjuh - Zona Industriale;
5. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre.

Brus, Hanrovc, Janjevë, Teqe: (15)

1. Asfaltimi i rrugicave në Janjevë,
2. Asfaltimi i rrugicave në Teqe
3. Asfaltimi i rrugicave në Brus;
4. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Brus
5. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Hanrovc,
6. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Janjevë,
7. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Teqe
8. Ndërtimi i shtratit të lumit në Janjevë dhe mirëmbajtja e tyre;
9. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i qendrës rinore në Janjevë;
10. Rikonstruimi i rrugës Janjevë – Hanrovc – Brus;
11. Renovimi i QMF-së në Janjevë;
12. Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në partneritet publiko-privat;
13. Funkcionalizimi i ujësjellësit;

14. Ndërtimi i shkollës në Brus;
15. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre.

Akllap(7)

1. Vazhdimi i asfaltimit të rrugicave;
2. Hapja dhe ndërtimi i rrugës Akllap – Sllovi;
3. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik;
4. Mirëmbajtja e shtratit të lumit;
5. Vazhdimi i zgjerimit të rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i ujësjellësit;
6. Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollë;
7. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre.

Sllovi, Smollushë: (12)

1. Asfaltimi i rrugicave në Sllovi;
2. Asfaltimi i rrugicave në Smollushë;
3. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik në Sllovi
4. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik në Smollushë;
5. Rrregullimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja e tyre;
6. Salla e sportit në Sllovi;
7. Renovimi i shkollës dhe instalimi i ngrohjes qendrore në Smollushë;
8. Ndërtimi i shkollës në Sllovi (te shkollë e vjetër); renovimi i AMF-së;
9. Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në partneritet publiko-privat;
10. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
11. Mirëmbajtja e hapësirave publike;
12. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Gadime e Epërme, Vrellë, Plitkoviq, Gadime e Ulët, Babush, Gllavicë, Marevc: (19)

1. Ndërtimi i rrugës së re transit nga rruga regjionale e Gjilanit – Gadime e Epërme deri në magjistralen Prishtinë - Ferizaj me qëllim të shkarkimit të transporteve nga Gadimja e Epërme dhe Gadimja e Ulët;
2. Asfaltimi i rrugës Gadime e Epërme –Gllavicë;
3. Asfaltimi i rrugës Gadime e Ulët – Babush – Cernillë;
4. Asfaltimi i rrugës deri te pishat e Gadimes;
5. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik;
6. Vazhdimi i ndërtimit të shtretërve të lumenjve;
7. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore;
8. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollës në Gadime
9. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollës në Gllavicë
10. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollës në Marevc
11. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollës në Vrellë;
12. Ndërtimi i ujësjellësit në Vrellë;
13. Ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat;
14. Renovimi i sallës së sporteve në Gadime;
15. Ndërtimi i fushave të sportit në Babush;
16. Renovimi i AMFsë në Babush;
17. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit;
18. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
19. Mirëmbajtja e hapësirave publike.

Llugaxhi, Bujari, Qallapek: (12)

1. Asfaltimi i rrugicave në Llugaxhi;
2. Asfaltimi i rrugicave në Bujari;
3. Asfaltimi i rrugicave në Qallapek;
4. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik në Llugaxhi;
5. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik në Bujari
6. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik në Qallapek;
7. Rregullimi i shtretërve të lumenjve;
8. Ndërtimi i fushave të vogla sportive në Bujari
9. Ndërtimi i fushave të vogla sportive në Qallapek;
10. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit;
11. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
12. Mirëmbajtja e hapësirave publike.

Banullë, Gllgovc: (7)

1. Asfaltimi i rrugicave;
2. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik;
3. Vazhdimi i rregullimit të shtretërve të lumenjve; ndërtimi i sallës së sporteve;
4. Ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat;
5. Renovimi i AMF-së; ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
6. Mirëmbajtja e hapësirave publike.
7. Përcaktimi dhe zhvillimi i zonës ekonomike për agrobiznes në zonën kadastrale në Banullë.

Rubovc, Kojskë, Pojatë: (10)

1. Asfaltimi i rrugicave në Rubovc;
2. Asfaltimi i rrugicave në Kojskë,
3. Asfaltimi i rrugicave në Pojatë
4. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik;
5. Renovimi i AMF-së;
6. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
7. Ndërtimi i rrugës Kojskë – Topliqan;
8. Mirëmbajtja e shtratit të lumit “Sitnica”;
9. Ndërtimi i fushave të vogla sportive;
10. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit.

Topliqan, Grackë e Vogël, Jeta e Re, Grackë e Vjetër: (13)

1. Asfaltimi i rrugicave; ndërtimi i rrugës Grackë e Vjetër – deri te rruga Lipjan– Kraishtë;
2. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Topliqan,
3. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Grackë e Vogël,
4. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Jeta e Re,
5. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Grackë e Vjetër,
6. Mirëmbajtja e shtratit të lumit “Sitnica”;
7. Ndërtimi i fushës së vogla sportive në Grackë të Vogël
8. Ndërtimi i fushës së vogla sportive në Grackë të Vogël
9. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit; ndërtimi i rrugës Topliqan-Kojskë;
10. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
11. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
12. Ndërtimi i AMF-së në Topliqan;

13. Rregullimi i infrastrukturës në shkolla.

Hallaq i Madh, Bujan, Bregu i Zi, Varigovc, Kraishtë: (10)

1. Asfaltimi i rrugicave në Hallaq i Madh ;
2. Asfaltimi i rrugicave në Bujan;
3. Asfaltimi i rrugicave në Bregu i Zi;
4. Asfaltimi i rrugicave në Varigovc;
5. Asfaltimi i rrugicave në Kraishtë ;
6. Asfaltimi i rrugës Hallaq i Madh – Rufc i Ri;
7. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik;
8. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
9. Renovimi i AMFsë;
10. Ndërtimi i fushave sportive në Bujan;

Bregu i Zi dhe Varigovc; (5)

1. Trajtimi i ujërave të zeza – ndërtimi i rrjetit të kanalizimit nga kolektorët;
2. Ndërtimi i shëtitorës deri te Kroji i Kraishtës;
3. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
4. Mirëmbajtja e hapësirave publike;
5. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Ribar i Madh, Zllakuqan: (13)

1. Asfaltimi i rrugicave në Ribar i Madh
2. Asfaltimi i rrugicave në Zllakuqan
3. Asfaltimi i rrugës Ribar i Madh – Torinë;
4. Asfaltimi i rrugës së varrezave;
5. Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve me ndriçim publik;
6. Ndërtimi i shtretërve të lumenjve;
7. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
8. Ndërtimi i sallës së sporteve në Ribar të Madh;
9. Ndërtimi i fushës së sportit në Zllakuqan;
10. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollave;
11. Investimi në hapësira publike dhe mirëmbajtja e tyre;
12. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
13. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Ribar i Vogël, Hallaq i Vogël: (15)

1. Asfaltimi i rrugicave; asfaltimi i rrugës Ribar i Vogël – Torinë;
2. Asfaltimi i rrugës Rufc i Vjetër – Rufc i Ri;
3. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Rufc i Ri;
4. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Rufc i Vjetër
5. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Ribar i Vogël
6. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Hallaq i Vogël
7. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollës në Hallaq të Vogël;
8. Ndërtimi i fushës së sportit në Hallaq të Vogël
9. Ndërtimi i fushës së sportit në Rufc të Ri;
10. Ndërtimi i sallës së sportit në Rufc të Ri;
11. Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit;
12. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve;

13. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
14. Rregullimi i urave mbi shtratin e lumit “Sitnica” në Rufc të Ri dhe Rufc të Vjetër;
15. Rregullimi i urës mbi shtratin e lumit “Janjevka”.

Poturovc, Torinë: (7)

1. Asfaltimi i rrugicave në Poturovc;
2. Asfaltimi i rrugicave në Torinë
3. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Poturovc
4. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Torinë;
5. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
6. Renovimi i shkollës së vjetër në Poturovc;
7. Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave publike.

Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë, Gllanicë: (17)

1. Asfaltimi i rrugicave në Dobrajë të Madhe,
2. Asfaltimi i rrugicave në Llugë,
3. Asfaltimi i rrugicave në Gllanicë,
4. Asfaltimi i rrugicave në Dobrajë të Vogël;
5. Asfaltimi i rrugës Llugë-Radevë;
6. Asfaltimi i rrugës Dobrajë e Vogël – Medvec;
7. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Dobrajë të Vogël;
8. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik;
9. Ndërtimi i fushës sportive në Dobrajë të Madhe;
10. Ndërtimi i fushës sportive në Dobrajë të Vogël ,
11. Ndërtimi i fushës sportive në Gllanicë;
12. Renovimi i shkollës dhe infrastrukturës në Dobrajë të Vogël,
13. Renovimi i shkollës dhe infrastrukturës në Llugë
14. Renovimi i shkollës dhe infrastrukturës në Gllanicë;
15. Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit dhe mirëmbajtja;
16. Vazhdimi i ndërtimit të stadiumit në Dobrajë të Madhe;
17. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Magure, Qylagë, Vërshevc, Leletiq, Medvec, Vrellë e Magures: (24)

1. Asfaltimi i rrugicave në Magure
2. Asfaltimi i rrugicave në Qylagë,
3. Asfaltimi i rrugicave në Vërshevc,
4. Asfaltimi i rrugicave në, Leletiq,
5. Asfaltimi i rrugicave në Medvec,
6. Asfaltimi i rrugicave në Magure, Vrellë e Magures
7. Asfaltimi i rrugës Magure – Dobrajë e Vogël;
8. Asfaltimi i rrugës Vershevc-Varrezat e Qylagës;
9. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik;
10. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Vrellë (Harilaq i Vogël); Leletiq dhe Vërshevc;
11. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Leletiq;
12. Ndërtimi i shtretërve të lumenjve; ndërtimi i hapësirave publike;
13. Renovimi i QMF-së në Magure;
14. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollave në Leletiq,
15. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollave në Qylagë,
16. Ndërtimi i infrastrukturës së shkollave në Vrellë e Magurës;

17. Ndërtimi i fushave të sportit në Leletiq
18. Ndërtimi i fushave të sportit në Vrellë;
19. Ndërtimi i stadiumit në Magure;
20. Ndërtimi i shëtitorës në Magure – Kroj Leletiq;
21. Ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat në Magure;
22. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
23. Mirëmbajtja e hapësirave publike;
24. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Mirenë, Bainsë, Resinoc: (13)

1. Asfaltimi i rrugicave në Mirenë,
2. Asfaltimi i rrugicave në Resinoc
3. Asfaltimi i rrugicave në Bainsë;
4. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit;
5. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Mirenë;
6. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Bainsë;
7. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Resinoc;
8. Ndërtimi i fushave të sportit në Resinoc
9. Ndërtimi i fushave të sportit në Mirenë;
10. Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollën e Resinocit;
11. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
12. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
13. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Shalë, Krojmir, Kleqkë, Divjakë: (22)

1. Asfaltimi i rrugicave në Shalë,
2. Asfaltimi i rrugicave në Krojmir;
3. Asfaltimi i rrugës në Divjakë;
4. Vazhdimi i ndërtimit të rrugës “Gryka e Shpëtimit”;
5. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në rrugët kryesore në Shalë
6. Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në rrugët kryesore në Krojmir;
7. Ndërtimi i fushave të sportit në Shalë
8. Ndërtimi i fushave të sportit në lagjen e Pojatave në Krojmir;
9. Funkcionalizimi i rrjetit të ujësjellësit në Shalë
10. Funkcionalizimi i rrjetit të ujësjellësit në Krojmir;
11. Zgjerimi dhe funksionalizimi i rrjetit të kanalizimit në Shalë
12. Zgjerimi dhe funksionalizimi i rrjetit të kanalizimit në Krojmir;
13. Hapja dhe mirëmbajtja e shtratit të lumit “Drenica”;
14. Ndërtimi i shtretërve të lumenjve në pjesët qendrore në fshatrat Shalë
15. Ndërtimi i shtretërve të lumenjve në pjesët qendrore në fshatrat Krojmir;
16. Renovimi i QMF-së; renovimi i shkollës në Krojmir;
17. Ndërtimi i infrastrukturës në shkollën fillore në Shalë;
18. Instalimi i ngrohjes qendrore dhe renovimi i shkollës së mesme në Shalë;
19. Ndërtimi i çerdhes me partneritet publiko-privat në Shalë;
20. Ndërtimi i AMF-së në Krojmir;
21. Ndërtimi i infrastrukturës në varreza dhe mirëmbajtja e tyre;
22. Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve.

Tabela 2. Vlerësimi i realizimit të premtimeve sipas vendbanimeve

Vendbanimet	Totali i premtimeve	Premtimet e plotësuar	%	Në realizim	%	Të pa realizuara	%
<i>Qyteti i Lipjanit</i>	14	3	21.42%	4	28.57%	7	50%
<i>Gadime të Epërme, Gadime e Ulët, Babush i Muhaxherëve, Vrellëe Gadimes, Plitkoviq, Gllavicë e Marec</i>	16	5	31.25%	3	18.75%	8	50%
<i>Llugaxhi, Gumnasellë, Çallapek, Banullë, Glllogovc, Rubovc dhe Kojkë</i>	9	5	55.55%	1	11.11%	3	33.33%
<i>Sllovi dhe Smallushë</i>	12	6	50.00%	4	33.33%	2	16.66%
<i>Janjevë, Akllap, Teqe, Brus, Tërbufc, Hanroc, Bukovicë, Okosnicë, Shisharkë dhe Vogaçicë</i>	11	5	45.45%	1	9.09%	5	45.45%
<i>Konjuh:</i>	5	2	40%	1	20%	2	40%
<i>Jetën e Re dhe Grackë e Vjetër</i>	4	1	25 %	0	0%	3	75%
<i>Topliçan, Grackë e Vogël dhe Bujan</i>	5	2	40%	1	20%	2	40%
<i>Bregu i Zi dhe Varigoc</i>	7	1	14.28%	1	14.28%	5	71.44%
<i>Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël, Rufci i Ri, Rufci i Vjetër dhe Ribari i Vogël</i>	5	2	40%	2	40%	1	20%
<i>Kraishtë:</i>	6	1	16.66%	1	16.66%	4	66.66%
<i>Ribari i Madh dhe Zllakuqan</i>	7	3	42.85%	2	28.57%	2	28.57%
<i>Torinë, Poturovc, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë dhe Gllanicë</i>	10	6	60%	2	20%	2	20%
<i>Magurë, Mirenë, Medvec, Qylagë, Vërshec, Leletiq, Blinajë dhe Vrellë e Goleshit</i>	12	5	41.66%	2	16.66%	5	41.66%
<i>Shalë, Kroimir, Baicë, Resinoc, Kleçkë dhe Divjakë</i>	8	1	12.5%	5	62.5%	2	25%
Totali	130	46	35.38%	32	24.61%	52	40.00%

Grafiku 3. Dinamika e realizimit të premtimeve nëpër vite 2014-2016



Problemet aktuale

Sikur se edhe në raportet e kaluara monitoruese Komuna e Lipjanit nuk po arrin kurrë se si ti zgjidhë problemet kryesore që po preokupohen qytetarët e Lipjanit, në këtë nuk e ka pas arritur as ekzekutivi i kaluar, por edhe ekzekutivi tanishëm nuk ka bërë as ndonjë përpjekje serioze në zgjidhjen e tri problemeve kryesore që sot qytetarët e Lipjanit preokupohen dhe ato janë:

- Problemi me ujërat e zeza si pasoj i mos trajtimit të tyre
- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;

Problemi me ujërat e zeza si pasoj i mos trajtimit të tyre: Komuna e Lipjanit është duke u përballur me një problem që dita ditës është duke u zgjeruar, i mos trajtimit të ujërave të zeza. Gjatë viteve të kaluara janë rregulluar një numër i sistemeve të kanalizimeve pa trajtimin e ujërave të zeza, pra pa kolektor, pa impiante për trajtim dhe këto ujëra janë derdhur drejtpërdrejtë në lumin Sitnica apo edhe nëpër fusha dhe livadhe. Këto ujëra të derdhura gjithnjë e më shumë po ndikojnë në ndotjen e ambientit jetësor dhe janë duke ndikuar edhe në shëndetin e qytetarëve.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Nuk ka lëvizje në këtë drejtim , edhe pse ne kemi bërë vërejtje që nga raporti e parë mbi punën e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe që është premtim më kryesor nga fushata zgjedhor që nga 2009-ta dhe 2013-tës nga kryetari i komunës Z. Imri Ahmeti.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimin e erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Transparenca dhe llogaridhënia

Ndër premtimet kryesore të Kryetarit Imri Ahmeti ka qenë edhe transparenca dhe llogaridhënia si dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e ekzekutivit ndaj qytetareve, ende po vazhdohet me një nivel të ultë në këto dy shtylla të qeverisjes së mirë. Pasi që, kryetari Imri Ahmeti vazhdon ti mbaj të mbyllura dyert, me anë te selektimin të organizatave të shoqërisë civile, në ato të përshtatshme dhe ato të jo të përshtatshme për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit të drejtorëve. Po ashtu po vazhdohet me bojkot me mos dërgimit të materialeve të kuvendit ndaj organizatave të interesuar që ta përcjellin mbledhjet e Kuvendit.

Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën 1 Janar-31 Maj 2017 ka arrit që të shpenzohet në masën 61.28% ose 4,322,584.51€ nga buxheti i alokuar prej 7,053,825.06 € ose 30.82 % nga buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2017, që është 14,025,258.00 €. Kjo shifër është e mirë e arritur në shpenzimin e buxhetit për periudhën pesë mujore në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e pritët të shpenzohen në tre mujorin e fundit të 2017.

Po ashtu e kemi një performancë të mirë edhe në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës ku deri me 31 Maj 2017 janë realizuar në vlerë 659,877.43 € ose 31.29 % nga planifikimi vjetor buxhetor që është 2,108,545.00 euro për vitin 2017. Realizimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë deri me 31.05.2017, është realizuar në vlerën 203,029.93 € ose 26.89 % nga planifikimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë që është për vitin 2017 është 755,000.00 €.

Planifikimi i të Hyrave nga Qiraja deri me 31.05.2017 është realizuar në vlerën prej 9,712.82 € ose shprehur në përqindje 13.11 % nga planifikim 74,100.00 € për vitin 2017 . Planifikimi i të Hyrave nga Lejet Ndërtimore deri me 31.05.2017 është realizuar 152,130.91 € ose 51.22 % nga planifikimi për vitin 2017 në vlerën prej 297,000.00 €. Planifikimi i të Hyrave nga Tregjet deri 31.05.2017, janë realizuar në vlerën 14,119.80 € ose 35.30 % nga planifikim për vitin 2017 që është 40,000.00€, Të hyrave nga Shfrytëzimi i Pronave Publike deri më 31.10.2016 është 3,679.87€ ose 73.60% nga planifikimi për vitin 2017 që është 5,000.00€.

Grafiku 4. Të hyrat komunal nga lloji i burimit




Tabela 3. Buxheti komunal i planifikuar 2017

Kategoria	shuma	%
Paga dhe Meditje	8,885,900.00 €	66.36%
Shpenzimet Kapitale	3,665,000.00 €	23.60%
Mallra dhe Shërbime	959,100.00 €	6.00%
Subvencionet dhe Transferet	325,160.00 €	2.52%
Shpenzimet Komunale	190,098.00 €	1.52%

Tabela 4. Buxheti komunal 2003/2016

Viti	Rrogat dhe meditet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transfere	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
------	--------------------	-----------------------	---------------------	----------------------------	---------------------	----------

2017	8,885,900 ▲	959,100 ▲	190,098 ▼	325,160 ▼	3,665,000 ▲	14,025,258 ▲
2016	8,658,911 ▲	782,630 ▼	198,390 ■	329,067 ▲	3,079,840 ▲	13,634,445 ▲
2015	8,297,000 ▲	956,030 ▼	198,390 ▼	157,000 ▼	2,790,834 ▼	12,399,254 ▲
2014	6,793,498 ▲	983,145 ▲	256,500 ▼	200,000 ▲	3,100,301 ▼	11,333,444 ▼
2013	6,738,235 ▲	815,573 ▲	204,746 ▲	179,550 ▲	3,301,197 ▼	11,973,991 ▲
2012	6,744,398 ▲	742,386 ▼	119,972 ▼	138,064 ▲	3,606,440 ▼	11,795,467.76 ▲
2011	6,580,682 ▲	752,815 ▲	130,707 ▼	88,273 ▲	4,113,220 ▲	11.317.613,69 ▲
2010	5,069,000 ▲	698,000 ▲	133,000 ▼	78,000 ■	3,376,000 ▲	9,456,417 ▲
2009	4,425,264 ▲	512,394 ▼	112,154 ■	80,000 ■	2,325,154 ▲	7,454,966 ▲
2008	3,868,282 ▲	554,288 ▲	112,154 ▼	80,000 ■	1,239,909 ▲	5,854,633 ▲
2007	3,718,294 ▼	537,335 ▼	202,154 ▲	80,000 ▼	1,127,138 ▲	5,664,921 ▲
2006	3,731,341 ▲	610,147 ▼	78,577 ▼	100,000 ▲	1,070,849 ▼	5,590,914 ▼
2005	3,696,996 ▼	621,827 ▼	126,381 ■	64,000 ■	1,180,077 ▲	5,689,281 ▲
2004	3,701,207 ▲	1,135,854 ▼	-	-	721,431 ▲	5,558,492 ▲
2003	2,770,014 ■	1,144,006 ■	-	-	465,113 ■	4,528,532 ■

▲ Rritje, ▼ Zvogëlim, ■ Nivel i njëjtë/mos ndryshim

Drejtoria e prokurimit

Drejtoria Komunale e Prokurimit gjatë kësaj periudhe raportuese ka filluar mirë. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2017, kemi mbi 181 tenderi të shpallura, nga të cilat kemi 20 tenderë ose 11.04 % të ri-tenderuar dhe 31 kontrata të nënshkruara me operator të ndryshme, duke filluar prej furnizimeve me material shpenzues për zyre deri tek investimet kapitale. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas publikimeve në faqen e KRPP-së është 1,532,600.35 €, ndërsa buxhet i planifikuara për investime kapitale është 3,665,000.00 €.

Grafiku 5. Aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Prokurimit




Tabela 5. LISTA E TËNDERVE TË KONTRAKTUARA NGA DREJTORIA KOMUNALE E PROKURIMIT NË LIPJAN GJATË PERIUdhËS JANAR-QERSHOR 2017⁴

	Kodi i kontratës	Emërtimi i kontratës	Pala kontraktuese	Vlera (me TVSH)	Data e nënshkrimit
1	613-17-886-5-2-1/C10	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Bainsë - Ri tenderim	Npsh Bageri	25.238,50 €	27.04.2017
2	613-17-852-5-2-1/C14	Ndërtimi i shkollës fillore SHFMU "Neze Bujani" Bujan paralele e ndare Bregu i Zi	N.T.P. "FERIZI"	148.392,23 €	10.05.2017
3	613-17-52-5-2-1/C2	Rregullimi i shtratit të Lumit në Fshatin Banullë	N.P.T. "Mali Art"	63.817,50 €	27.03.2017
4	613-17-524-5-2-1/C7	Asfaltimi i rrugës Grackë - Topliqan	Npsh Bageri	32.999,25 €	20.04.2017
5	613-17-369-5-2-1/C6	Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në Konjuh	N.SH.P " Dimi - Bau "	36.434,60 €	07.04.2017
6	613-17-298-5-2-1/C5	Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në fshatin Llugaxhi- faza e dytë	N.T.P.,,Rexha Com"	27.906,50 €	03.04.2017
7	613-17-28-1-3-6/C1	Furnizimi me kalorifer elektrik	N.T.SH. " MEGRANT ING "	1.573,73 €	14.02.2017
8	613-17-191-5-2-1/C4	Ndërtimi i rrethojave në shkollat Baicë,Kraishtë,Bujari dhe përfundimi i rrethojës në SH.F."Ismail Luma"në Lipjan	Grup i Operatorëve Ekonomik: " BEREQETI - ING " SH.P.K.; N.N.T. " Brezi Kufitar "	38.891,60 €	03.04.2017
9	613-17-1893-5-2-1/C34	Renovimi i Shkollave në Ruc të Ri, Dobrajë, Babush dhe rregullimi i oborrit në SHF Blinajë	N.N." GLOBAL - ING "	58.677,40 €	20.06.2017
10	613-17-186-5-2-1/C3	Rregullimi i shtratit të Lumit në Gadime të Ulet dhe Gadime të Epërme	" LEDI ING " SH.P.K.	28.978,84 €	27.03.2017
11	613-17-1711-5-2-1/C32	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Ruboc i Vogël	N.T.P. "FERIZI"	30.165,95 €	09.06.2017
12	613-17-1697-5-2-1/C39	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Ruboc i Vogël	NNTP " Gashi Ing "	21.702,50 €	16.06.2017

⁴ Shënime janë marrë nga ueb faqja zyrtare e KRPP-së (Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik të Kosovës) deri në ora 01.34 të datës 30.06.2017.

13	613-17-1664-5-2-1/C30	Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Smallushë	KNPSH. "PAPENBURG & ADRIANI COMPANY" Sh.p.k.	41.325,50 €	07.06.2017
14	613-17-1598-5-2-1/C27	Asfaltimi i rrugicave në lagjet e fshatit Krojmir	Grup i Operatorëve Ekonomik: " KOSOVA ASFALT " SH.P.K.; Npsh Bageri	55.000,00 €	30.05.2017
15	613-17-1537-5-3-6/C22	Rregullimi i oborrit në SHFMU "Hasan Prishtina" në Llugaxhi 16dhe SHFMU "Migjeni" në Rufc i Ri	Grup i Operatorëve Ekonomik: N.P.P."KRYEZIU 2"; N.N." GLOBAL - ING "	7.456,00 €	24.05.2017
16	613-17-1522-5-2-1/C26	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në rrugicat e qytetit të Lipjanit	N.T.SH." INLINE ENGINEERING "	28.984,64 €	01.06.2017
17	613-17-1496-5-2-1/C31	Hapja dhe zhavorrimi i rrugës lidhëse mes dy rrugëve regjionale në zonën e biznesit.	"EL-BAU" SH.P.K.	9.805,00 €	07.06.2017
18	613-17-1408-5-2-1/C28	Ndërtimi i fushave të vogla sportive-Kontrate dy vjeçare	N.N.P. " ATC COM " SH.P.K.	279.952,10 €	01.06.2017
19	613-17-1360-5-2-1/C18	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Resinovc	Grup i Operatorëve Ekonomik: " KOSOVA ASFALT " SH.P.K.; Npsh Bageri	51.331,55 €	18.05.2017
20	613-17-1354-5-2-1/C24	Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në fshatin Sllavi-Projekt dy vjeçar	"Linda" Sh.p.k	84.998,04 €	31.05.2017
21	613-17-1350-5-2-1/C20	Asfaltimi i rrugës Poturovc-Torinë	" Trasing Group " Sh.p.k.	37.350,70 €	17.05.2017
22	613-17-1275-5-2-1/C19	Asfaltimi i rrugicave në lagjet e fshatit Ribar i Vogël- Ri tenderim	Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.P. " LINDALB "; " Trasing Group " Sh.p.k.	28.294,50 €	17.05.2017
23	613-17-1268-5-2-1/C23	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Jeta e Re-Projekt dy vjeçar	Grup i Operatorëve Ekonomik: " KOSOVA ASFALT " SH.P.K.; Npsh Bageri	58.443,12 €	29.05.2017
24	613-17-1233-5-2-1/C21	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Hallaq i Madh	NNTPP " Gashi Ing "	42.403,00 €	18.05.2017
25	613-17-1223-5-2-1/C11	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Banullë- ritenderim	Grup i Operatorëve Ekonomik: " KOSOVA ASFALT " SH.P.K.; Npsh Bageri	45.614,92 €	04.05.2017

26	613-17-1220-5-2-1/C13	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në Fshatin Mirenë faza e dyte	N.N.SH: "Xhema Com"	23.405,50 €	08.05.2017
27	613-17-1218-5-2-1/C15	Ndërtimi i trotuareve me ndriçim publik në fshatin Smallushë	N.T.P.,,Rexha Com"	71.507,80 €	11.05.2017
28	613-17-1183-5-2-1/C17	Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Zllakuqan	NNTPP " Gashi Ing "	30.722,50 €	17.05.2017
29	613-17-1058-5-2-1/C12	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Shalë-projekt dy vjeçar	N.T.SH. " Dino " Sh.p.k.	96.841,88 €	08.05.2017
30	613-17-1035-1-2-1/C16	furnizimi me pajisje speciale mjekësore	N.T.SH. " Atom - Med "	17.995,00 €	11.05.2017
31	613-17-1013-1-3-6/C9	Furnizimi me farëra, herbicide dhe material tjetër për mbjellje pranverore dhe vjeshtore- ri tenderim	"SEMENARNA" SH.P.K.	6.390,00 €	25.04.2017

Arsimi

Me nisjes së mandatit të parë të kryetari aktual Imri Ahmeti, sistemi arsimor në Lipjan është përballur me këto probleme kryesore:

1. Gjendja jo e mirë e infrastrukturës shkollore;
3. Numri i madh i nxënësve për paralele në shkollat e mesme;
3. Mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik;

Po ashtu, ndër problemet tjera që janë evidentuara në këtë vit 2017, janë se pjesa dërrmuese e shkollave në Komunën e Lipjanit janë në gjendje të keqe infrastrukturore .

Problemet të cilët aktualisht hasën në sistemin arsimor në Lipjan janë ato në shkollat e mesme, përkatësisht me numrin e madh të nxënësve në to që në shumicën e rasteve ky numër është afërsisht 40 nxënës për një klasë dhe po ashtu problem në vete paraqet mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik.

Tabela 6. Numri i nxënësve dhe i personelit arsimor në Komunën e Lipjanit⁵

	Arsimi Komunal		Personeli		
	Nr. i institucioneve	Nr. i nxënësve	Nr. i Mësimdhënësve	Nr. i personelit administrativ	Nr. i personelit ndihmës
<i>Institucione parashkollore publike</i>	1	88	8	2	7
<i>Shkolla fillore, të mesme të ultë / publike</i>	51	9,581	668	44	113

⁵ <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-shq.pdf>

Shkolla të mesme publike
Shkolla apo kolegje private
Gjithsej

4	2,895	88	7	13
1	/	/	/	
56				

Shëndetësia

Po ashtu është shqetësuese gjendja në sektorin e shëndetësisë, për kundër angazhimeve të shumta të Drejtorisë Komunal për Shëndetësi në Komunën e Lipjanit, që të përmirësojë gjendjen ekzistuese në sektorin shëndetësor, prapë se prapë gjendja ka qenë katastrofale në këtë sektor, me fajin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ka pasur mungesë të gjerave elementare duke filluar nga shiringat, gypin përcjellës për infuzione, dorëzat sterilizuese për personelin mjekësorë, fashat, cilindrin mbushës me oksigjen dhe plotë gjëra të tjera që i duhen një pacienti për të marrë një intervenim emergjent.

Tabela 7. Struktura e punëtorëve në QKMF në muajin Maj te vitit 2017

Totali Punëtor	Struktura Kualifikuese				Struktura Etnike								Struktura Gjinore	
	Superiore	I/e lartë	Sh. e Mesme	Sh. Filllore	Sh	S	B	Kro.	A	R	Te tjerë		Meshkuj	Femra
187	56	0	132	0	178	5	1	2	1	0	0		65	122
Totali Punëtor Administrate	Struktura Kualifikuese				Struktura Etnike								Struktura Gjinore	
	Superiore	I lartë	Sh. e Mesme	Sh. Filllore	Sh	S	B	Kro.	A	R	Te tjerë		Meshkuj	Femra
12	2	0	10	0	12	0	0	0	0	0	0		8	4
Totali Punëtor Sh. Teknike	Struktura Kualifikuese				Struktura Etnike								Struktura Gjinore	
	Superiore	I lartë	Sh. e Mesme	Sh. Filllore	Sh	S	B	Kro.	A	R	Te tjerë		Meshkuj	Femra
37	0	0	31	6	37	0	0	0	0	0	0		24	13
Totali i punëtorëve					236	Meshkuj			97	Femra			139	

Me këtë përveç që pacient do të kishte shpenzime materiale , ata rrezikohen edhe me humbjen e kohës për të marrë ndonjë intervenim mjekësorë për shëndetin e tij dhe njëkohësisht me këtë i rrezikohet edhe jeta e tij në raste të rënda.

Pas thirrjes së organizatës sonë ndaj ekzekutivit të Komunës së Lipjanit që të angazhohet maksimalisht në kujdesin shëndetësor për qytetarët e vetë, drejtoria komunale e shëndetësisë është përgjigjur pozitivisht, duke ndarë mjete buxhetore për plotësimin e këtyre mungesave të medikamenteve e cila është si pasojë e një menaxhim të keq nga Ministria e Shëndetësisë.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Komunën e Lipjanit përlllogariten sipas Rregullores komunale mbi pronën. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore.

Realizimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë deri me 31.05.2017, është realizuar në vlerën 203,029.93 € ose 26.89 % nga planifikimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë që është për vitin 2017 është 755,000.00 €. Krahasuar me periudhën e njëjtë me vitin 2016, që ishte 221,112.28 €, kemi një ulje prej 8.18 %. Ky trend është mjaft pozitiv, por duke marrë parasysh se në këtë vit kemi një rritje të planifikimit të hyrave vetanake në shumë prej 2,108,545.00€.

Ligji mbi faljen e borxheve si duket nuk është duke dhënë rezultatet e pritura. Shumë pak janë të hyra janë realizuar nga ky Ligj. Po ashtu, Sektori i Tatimit në pronë është duke u ballafaquar me probleme dhe me pasaktësi në gjenerimin e raporteve nga Sistemi elektronik i Tatimit në Pronë.

Deri me 31 Maj 2017 janë lëshuar 920 certifikata të tatimit në pronë me qëllim të regjistrimit të veturave nga ana e qytetarëve, ndërsa 481 certifikata janë lëshuar për kryerje ndonjë shërbim në kadastër dhe për humbje të nënshtetësisë. Janë lidhur katër marrëveshje për pagesën e tatimit në prone me këste dhe janë regjistruar 46 kontrata të shitblerjes në programin e tatimit në pronë. Në terren janë regjistruar 39 objekte të reja , janë modifikuar 98 objekte tjera dhe janë verifikuar 79 objekte të cilat nuk kanë pasur ndryshim.

Rekomandimet:

1. Angazhim më i madh i Kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale;
2. Menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike;
3. Ofrim i qasjes në informacion dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara;
4. Komunikim më kualitativ me shoqërinë civile dhe media;
5. Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal;
6. Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;
7. Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
8. Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukture;
9. Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore ,
10. Përmirësimi i bazës të dhënave mbi tatimin në pronë,
11. Integrimin e një programi kompjuterikë kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacione për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë,

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shkurt-Qershor, 2017.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2016. (<http://mefrks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);

3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2017-2019 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2013 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2016.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitet e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2017.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2016. Janar, 2016.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2016. Shtator, 2016.
12. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2014.
13. Programi zgjedhor i LDK-së dega Lipjan , Nëntor 2013,
14. Raporti Komunal Lipjan i Institutit për studime të Avancuara GAP , 2017,
15. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar-Qershor 2017,
16. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit Janar-Qershor 2017 <http://kk.rks-gov.net/lipjan/Municipality/Raportet-Mujore-te-Drejtorateve.aspx> ,
17. Raporti i kryetarit për vitin 2014 <http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti-per-Vitin-2014.pdf.aspx>.
18. Raporti i kryetarit për vitin 2016 [http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Kryetari/Raporti-i-Kryetarit/Raport-i-punes-i-Zyres-se-Kryetarit-dhe-Drejtorateve-Komunale-\(1\).pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Kryetari/Raporti-i-Kryetarit/Raport-i-punes-i-Zyres-se-Kryetarit-dhe-Drejtorateve-Komunale-(1).pdf.aspx).
19. Komunikatat për media të YAHR-it Janar-Qershor 2017.
20. <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/Biografia-e-Kryetarit.pdf.aspx>,
21. <http://zgjedhjet2013.weebly.com/programet-e-partive-politike-peumlr-zgjedhjet-2013.html>,
22. <http://zgjedhjet2013.weebly.com/tv-debatet.html>,



